REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:182958
Datë: 21.02.2024
Numri i dokumentit: 05353522

Ac.nr.6969/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naim Meholli kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditëses L.H, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim F.B, për objektin e kontestit kompensim i diferencës për licencim, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.6151/2021, i datës 08.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.6151/2021, i datës 08.06.2022, në pikën I dhe III të dispozitivit të aktgjykimit, **VËRTETOHET.**

II. Mbetet e pashqyrtuar pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.6151/2021, i datës 08.06.2022 ka vendosur si në vijim:

"I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia paditëses L.H nga Prishtina, të cilën me autorizim e përfaqëson Av. RR.H nga Prishtina, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Arsimit, që paditëseve për periudhën nga data 01.06.2018 deri më 21.07.2021, e në total 37 muaj (tridhjete e tete muaj) në emër të diferencës së papaguar në pagë në bazë të licencimit- gradimit, tija kompensojë shumën prej 1,911.42€ (njëmijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë € e dyzet e dy cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (21.07.2021) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarimit me dhunshëm.II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit mbi shumen e gjykuar si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për periudhën 18.05.2017 e deri me datën 31.05.2018, dhe atë në shumen prej 671.58€ (gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë € e tetëdhjetë cent). III. OBLIGOHET e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 259€ (dyqind e pesëdhjetë e nënte €), në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi,

2022:223548

nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarimit me dhunshëm".

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën t'a aprovojë si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje ose ta ndryshojë duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditëses.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësja.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit së saj, me datë 21.07.2021 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar diferencën e pagës për shkak të kualifikimit apo licencimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.6151/2021, i datës 08.06.2022, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nga provat e administruara shihet se paditës dhe e paditura kanë lidhur marrëdhënie pune, gjë që për palët dhe gjykatën ky fakt nuk ka qenë asnjëherë kontestues gjatë shqyrtimit të çështjes, pasi që kjo çështje vërtetohet edhe nga kontrata e punës së paditësit, të nënshkruara me të padituren, me atë të së cilave është themeluar marrëdhënien e punës, paditësit në cilësinë e mësimdhënësve-punëmarrës ndërsa e paditura si punëdhënëse. Meqenëse nuk ka qenë kontestuese marrëdhënia e punës në mes paditësit dhe të padituren, gjykata nuk është lëshuar në analizimin e fakteve të tilla, pasi për palët ndërgjyqëse nuk kanë qenë kontestuese. Nga këto pretendimet gjykata ka vlerësuar se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit bazohet në Kontratën Kolektive të Arsimit e vitit 2017 respektivisht neni 7 par.1 pika 1.3 dhe 1.4, si dhe nga kjo dispozitë ligjore të padituren i ka lindur detyrimi për kompensimin e kësaj diference në pagë tek pala paditëse, për më tepër vet pala e paditur në mënyrë të heshtur ka pranuar këtë detyrim ndaj paditësit, në momentin që e njëjta u ka paguar për çdo muaj në emër të kualifikimit me fakultet paditëses L.H me fakultet shumën prej 54.45 €. Po ashtu nga lista e pagave shihet se paditëses L.Hi në emër të kualifikimit me fakultet, i takon lartësia prej 27% të pagës bazë, ndërsa i është paguar shuma prej 54.45 €, e që në fakte është dashur të paguhet 106.11 €, çka do të thotë se e paditura ka hyrë në detyrim tek paditësi për këtë për 37 muaj nga 51.65 €, apo në shumë të përgjithshme prej 1,911.05€, andaj kjo përllogaritje për gjykatën ka qenë e saktë dhe reale dhe nuk ka kërkuar ekspertizëe shtesë. Andaj bazuar në këto përllogaritje dhe në dispozitat ligjore, gjykata e shkallës së parë ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses sa i përket lartësisë së saj, andaj dhe i ka njohur këtë të drejtë në kompensim në emër të licencimit për paditësen L.Hi në totalin e shumës prej 1,911.05 €.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 02.12.2020, ku ka marrë datën e ushtrimit të padisë ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive te detyrimit.Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 452 paragrafi 3 dhe nenit 463 të LPK-së.

2022:223548

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Pretendimet e të padituërës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në parashkrim të në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) sepse dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin si dhe i njëjti nuk mund të ekzaminohet nuk qëndrojnë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Pretendimi se kompensimi i tillë nuk parashihet me Ligj të Punës e as me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj gjykata gabimisht ka vendosur në këtë çështje nuk qëndron nuk qëndrojnë, sepse Ligji i Punës në raport me këto kategori të referon në Kontratë Kolektive gjë që kjo sipas Kontratës Kolektive parashihet dhe se mbi këtë bazë paditëses i takon kompensimi.

Mungesa e linjës së veçantë buxhetore nuk nënkupton lirim nga përgjegjësia e të padituërës pasi raporti në mes të nivelit lokal dhe atij qendror nuk afekton në të drejtën e paditëses për kompensim.

Me nënshkrimin e Kontratës Kolektive nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe përfaqësuesit të paditëses të sektorit të arsimit, Ministria ka marrë obligime në emër dhe llogari të të padituërës, ndërsa obligimi për kompensim bie mbi të padituërën pasi është punëdhënës i paditëses. Koordinimi ndërmjet nivelit lokal (Komunës) dhe nivelit qendror (Qeverisë-Ministrisë) nuk afekton në të drejtën e paditëses.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, por vlerëson se të njëjtat nuk qëndrojnë dhe se nuk kanë peshë në vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton të provohet fakti se paditëses me aktvendimin mbi licensimin e mësimdhënësit të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me nr. të protokollit 100013350 i datës 13.06.2013 i është pranuar kërkesa për licensim.

Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin, nr.01/33, i datës 29.08.2008 në pikën 1 ka vendosur që: *Nga 1 shtatori i vitit 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave në bazë të kritereve të licensimit*, ndërsa pika 4 ka përcaktuar se: *"Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: 1) Me diplomë të shkollës normale përfitojnë ngrite të pagës bazë prej 10%; 2) Me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagë bazë prej 19% 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%, 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%"*

2022:223548

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se paditësja ka diplomë universitare me përgatitje të fakultetit, ndërsa nga lista e pagave vërtetohet se paditësja ka pagën bazë në shumë prej 438.58 €, kualifikimin me fakultet, ndërsa diferenca i është paguar në shumë prej 54.45 €, mirëpo nuk ju ka paguar pjesa tjetër e cila do te arrinte shumen e 27% të pagës bazë, krejt kjo duke u bazuar në përgatitjen shkollore të paditëses, të paraparë me dispozita ligjore

Në rastin konkret, Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është vendosur kur paditëses i është aprovuar kërkesëpadia edhe lidhur me kompensimin e diferencës në pagë në emër të licensimit, ani pse Gjykata e Shkallës së parë është thirrur se kjo e drejtë është përcaktuar me Kontratën Kolektive të Arsimit, kjo Gjykatë vlerëson se kjo e drejtë nuk derivon nga Kontrata Kolektive e Arsimit edhe pse është e përcaktuar me të. Ky përfundim i Gjykatës së Apelit, vie edhe nga ***Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A-Su.A, 214/2023, i datës 05.10.2023***, ku është përcaktuar se për kërkesa e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licensimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33, i datës 29.08.2008. Pra vendimi i Qeverisë së RKS, ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023 deri në periudhën kur edhe është shfuqizuar, dhe ky vendim që është dashur që të zbatohet që nga dita e nënshkrimit e deri në momentin kur ka qenë në fuqi, e që e paditura duke vepruar në kundërshtim me këtë vendim i'a ka mohuar paditëses një të drejtë që i ka takuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se çështja e asaj se paditësja paguhet sipas kontratës së punës që dhe e njëjta është paguar gjegjësisht ka marr shtesën në shumë prej 54.45 €, ky pretendim është tejet irrelevant, pasi që kemi një Vendim të vetë Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka pasur karakter detyrues dhe si i tillë është dashur detyrimisht të zbatohet, pavarësisht asaj se çka është përcaktuar me kontratë sepse me kontratë përcaktohet fillimisht paga bazë, ndërsa sa i përket shtesat janë përcaktuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33, i datës 29.08.2008.

Sa i përket afatshmërin e licencës, gjykata gjeti se , me Udhëzimin Administrativ me nr. 5/2017 sistemimi i licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë, ne nenin 33 paragrafi 1.1 përcaktohet se "Vazhdohen për pesë vjet licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014. Licencat e lëshuar në këto vite mbeten të vlefshme deri në përudhen e realizimit të VPM". Në rastin konkret paditësja është pajisur me licencë me dt.13.06.2013, e ne bazë të udhëzimit administrativ të lartcekur të njëjtës i është vazhduar licenca edhe për 5 vite, që nënkupton që për vitet që ka kërkuar kompensim në emër të licencës e njëjta ka pasur licencë.

Lidhur me kamatën është vendosur konform nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 02.12.2020.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 paragrafi 3 dhe nenit 463 të LPK-së. Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në pikën II të dispozitivit në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, ngase nuk kishte pretendime ankimore në këtë drejtim.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6969/2022 me datë 21.02.2024

Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari

2022:223548

Numri i lëndës: 2021:182958
Datë: 21.02.2024
Numri i dokumentit: 05353522

Naim Meholli

2022:223548